



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI I QARKUT FIER**

**PROGRAMI I TRANSPARENCËS**

**I. HYRJE**

Në përputhje me nenin 7 të ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përgatitur Programi i Transparencës për “Këshillin e Qarkut Fier”

Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimitarisë së “Këshillit të Qarkut Fier” në kuadër të Ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Këshilli i Qarkut Fier ndërton dhe rrit transparencën e punës së tij, nën garancinë e Ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimitarisë së punës Këshillit të Qarkut nëpërmjet pasqyrimin të detajuar të tij në faqen zyrtare Fier [www.qarkufier.gov.al](http://www.qarkufier.gov.al), si dhe në mjediset e zyrave për publikun.

Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e Këshillit të Qarkut mundëson informacion për publikun pa kërkesë, në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj.

**II. PARIME TË PËRGJITHSHME**

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi i Transparencës së Këshillit të Qarkut janë:

1. “E drejta për informim” është e drejtë Kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshëm nga të gjithë pa asnjë përjashtim.
2. Informacioni që lidhet me veprimtarinë e Këshillit të Qarkut publikohet në përputhje me legjisllacionin në fuqi.
3. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë Këshillit të Qarkut dhe përkatësisht: Ligji Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

4. Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.
5. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
6. Rishikimi i programit të transparencës bëhet në përputhje me Nenin 5 të Ligjit 119/2014, “Për të drejtën e informimit”.
7. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:
  - i plotë;
  - i saktë;
  - i përditësuar;
  - i thjeshtë në konsultim;
  - i kuptueshëm;
  - lehtësisht i aksesueshëm;
  - i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

### **III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË**

Në përputhje me këtë Program Transparence të miratuar, Këshilli i Qarkut Fier vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit [www.qarkufier.gov.al](http://www.qarkufier.gov.al) dhe në mjediset e informimit publik, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Strukturën organizative të Këshillit të Qarkut
- Tekstet e plota, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, dokumente politikash, të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij dhe që prek publikun e gjerë; ato që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të Këshillit të Qarkut, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit;
- Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, si dhe dokumente që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;
- Informacion për shërbimet që autoriteti i jep publikut, informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh, çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik;
- Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik, procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e politikave apo ushtrimin e funksioneve të Këshillit të Qarkut, një përshkrim të thjeshtë të

sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë.

- Informacion për procedurat e prokurimit, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura, shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara, informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme
- Informacion për shërbimet që autoriteti i jep publikut, përfshirë standartet për cilësinë e shërbimit, një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për ti përfituar ato, informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh, çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik.

#### IV. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË KËSHILLIT TË QARKUT BERAT

Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë	Baza ligjore	Dokumenti/ Përbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse
Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik.	Neni 7/1/a/d	Vendimi për miratimin e strukturës organizative të KQF. Organigrama e funksionimit të administratës .	Menjëherë pas shprehjes së ligjshmërisë nga Prefekti.	Në faqen zyrtare të web-it, klike Administrata.	Sektori Burimeve Njerëzore
Ligje, Akte nënligjore Udhëzime, Dokument politikash, Dokument tjetër	Neni 7/1/b	Ligje Udhëzime Rregullore Vendime të KQF, Urdhëra	Pas publikimit në fletoren zyrtare Menjëherë pas shprehjes së ligjshmërisë nga Prefekti ”	Në faqen zyrtare të web-it, ne menu-nw Vendime	Specialist për shërbimet Juridike
Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin	Neni 7/1/c	Kërkesë klike Ankesë klike Adresë email: Adresë postare	Pas miratimit të Programit të transparencës. Menjëherë në rast ndryshimesh.	Në faqen zyrtare, të web, në menu-nw “ Program i Transparencës”.	Koordinatori për të Drejtën e Informimit E.Metaj.

e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.					
Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të KQB, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	Neni7/ 1/ç	Dokument me informacion të detajuar me të dhëna për vendndodhjen e zyrave të KQF, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit. Informacion shpjegues.	Pas nxjerrjes së urdhërit për caktimin e “Koordinatorit për të Drejtën e Informimit”.	Në faqen zyrtare, në menu-nw “ Program i Transparencës”.	Koordinatori për të Drejtën e Informimit, E.Metaj
Përshkrim i procedurave të zgjedhjes, kompetencave të funksionarëve të lartë dhe procedura e ndjekjes për marrjen e vendimeve.	Neni 7/1/d	Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.	Menjëherë pas botimit në fletoren zyrtare.	Në faqen zyrtare të web-it, në menu-nw Vendime	Specialisti për Shërbimet Juridike  Sekretari i Këshillit
Mekanizmat monitorues; raporte auditivi; dokumentet me tregues performance.	Neni7/ 1/dh	Raporte monitorimi dhe auditivi. Dokument tregues performance	Menjëherë pas depozitimit në KQF	Në faqen zyrtare të web-it, , në menu-nw“Sektori i Financë, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve mbështetëse”	Sektori i Burimeve Njerëzore.
Buxheti	Neni 7/1/e	Buxheti Raporte	Menjëherë pas miratimit nga KQF	Në faqen zyrtare të web-it, , në menu-nw” Sektori i Financës.	Sektori Ekonomik dhe Financiar.
Informacion për procedurat e prokurimit.	Neni 7/1/ë	Regjistri i Prokurimeve	Menjëherë pas dërgimit në APP	Në faqen zyrtare të web-it, , në menu-në Sektori Financë.	Juristi

Paraqitja e mendimeve në hartimin e p/akteve, etj.(projekt vendime)	Neni 7/1/gj	Projekt akt/ vendim	Menjëherë pas nënshkrimit të relacionit.	Në faqen zyrtare të web-it	Specialisti për Shërbimet Juridike, Sp/financës
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligjit Nr.119/2014	Neni 7/1/i	Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve sipas nenit 8 të Ligjit Nr.119/2014	Pas miratimit të Programit të Transparencës.	Në faqen zyrtare, në menu-nw “ Program i Transparencës”	Koordinatori për të Drejtën e Informimit E.Metaj.
Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh.	Neni 7/1/k	Vendime për “Tituj Nderi”, Statusi “Dëshmori të Atdheut” dhe të Komisionit të Vlerësimit të Nevojave.	Sipas afateve ligjore të miratimit dhe publikimit të tyre.	Në faqen zyrtare të Web-it, , në menu-në “ Vendime”.	Sekretari i Këshillit të Qarkut

## V. PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë Program Transparence të miratuar, Këshilli i Qarkut Fier vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit [www.qarkufier.gov.al](http://www.qarkufier.gov.al) dhe në mjediset e informimit publik, kategoritë e mësipërme, në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës”.

## VI. MONITORIMI

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit.

Komisioneri bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës, nëpërmjet pasqyrimin te detajuar te tij ne faqen zyrtare [www.idp.al](http://www.idp.al).